

Siguri

# Ekskluzive | Arsenal i fshehur në tri shtëpi të braktisura në Zubin Potok – Policia sekuestron qindra fishekë, armë dhe pajisje ushtarake



Sinjali.com

05 Korrik 2026 11:27



**Një operacion i Policisë së Kosovës në Zubin Potok ka rezultuar me zbulimin e një sasive të konsiderueshme municioni, armësh dhe pajisjesh ushtarake të fshehura në tri shtëpi të pabanuara në fshatin Bërllatë, raporton Sinjali.**

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se aksioni është zhvilluar rreth orës 02:10 të mëngjesit, kur njësia e NJRSH-së së Mitrovicës së Veriut ka hasur në disa objekte të dyshuara, për të cilat më pas janë njoftuar njësitë relevante të Stacionit Policor në Zubin Potok.

Gjatë kontrolleve janë sekuestruar:

- 432 fishekë të kalibrit 7.62 mm;
- 195 fishekë të kalibrit 7.9 mm;
- 20 fishekë të kalibrit 16 mm;
- 18 fishekë të armës së gjatë, me kalibër ende të paidentifikuar;
- 5 fishekë të armës së gjatë, me kalibër të panjohur;
- 4 fishekë të mbushur të kalibrit 16 mm;
- 56 gëzhoja të zbrazëta të armës së gjuetisë;
- një pushkë ajrore;
- një bajonetë (thikë ushtarake);
- një maskë ushtarake;
- tri pajisje ushtarake për ushqim;
- si dhe 40 mijë dinarë të vjetër jugosllavë, pa vlerë monetare.

Të gjitha provat materiale janë sekuestruar nga Policia.

Për momentin, autoritetet nuk kanë arritur ta identifikojnë pronarin e shtëpive ku u gjet arsenal, ndërsa me urdhër të Prokurorit të Shtetit është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Hetimet janë në vazhdim, me qëllim identifikimin e personave përgjegjës dhe zbardhjen e origjinës së arsenalit të sekuestruar.

**Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!**

**/GazetaSinjali/**

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera